

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shenjat e horoskopit që janë të tmerrshme në marrëdhënie dhe pse
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/18/shenjat-e-horoskopit-qe-jane-te-tmerrshme-ne-marredhenie-dhe-pse/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:05:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:02:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1072aa55d320fdd11feadd3ab07ab4c83f3414393c1e484aeb0459a92c156b3b
TEKSTI	ebae33e5d816de63241d570ea4328f709a72123058b3843140ba1d3ff9c5a9ae
PAMJA	ba7cffa81587f5ac44db113798186d2fbf31615ec834653df4be651df0c991b8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f037923fd1096bcd1861f12bf13b17db5e045dfca924188907e3cdc7bedd4a02
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f037923fd1096bcd1861f12bf13b17db5e045dfca924188907e3cdc7bedd4a02>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > HOROSKOPI

Shenjat e horoskopit që janë të tmerrshme në marrëdhënie dhe pse

18:02 : 18/09/2026 në HOROSKOPI



Kur ke pasur shpresa të mëdha për një lidhje, por gjithçka përfundon thuajse papritur, është e natyrshme të kalosh një periudhë trishtimi. Pyet veten se çfarë ndodhi, pa kuptuar se çdo shenjë e horoskopit ka zakone jo fort të mira në marrëdhënie, të cilat ndikojnë edhe në mënyrën se si dashuron.

Çdo shenjë ka një model të caktuar në marrëdhënie dhe astrologjia sugjeron se nuk është vetëm përputhshmëria ajo që ndikon në mënyrën se si dikush dashuron një person tjetër apo çfarë e shtyn të largohet.

Të kuptosh se çfarë e bën secilën shenjë të vështirë në një marrëdhënie mund të të ndihmojë të kuptosh se ku duhet të punosh me veten dhe, shpresojmë, të ndërtosh marrëdhënie më të mira në të ardhmen.

Ja pse shenja jote është e tmerrshme në marrëdhënie

Dashi

Lexo edhe:

[Horoskopi për ditën e premte, 18 Shtator 2026](#)

[Horoskopi 17 shtator/ Nga dashuria te paratë, si do shkojë dita për secilën shenjë](#)

Për Dashin, marrëdhëniet romantike mund të përfundojnë para se të kenë nisur vërtet, sepse kjo shenjë nuk i trajton gjithmonë gjërat me kujdes dhe vëmendje. Dashi bën plane pa e përfshirë partnerin dhe më pas habitet kur ai përballet me të për këtë sjellje.

Edhe nëse e ka menduar se partneri mund ta linte pa përgjigje, Dashi nuk jep përshtypjen e dikujt që është vërtet i përkushtuar ndaj një marrëdhënieje afatgjatë. Është në rregull të tregohesh i rezervuar, por jo deri në pikën që ta mbash partnerin plotësisht larg jetës tënde.

Demi

Demi është i vështirë në marrëdhënie për shkak të të gjitha provave dhe sprovave që i vendos përballë një partneri, për t'u siguruar se ai është personi i duhur. Por Demi kalon aq shumë

TË GJITHA



Shenjat e horoskopit që janë të tmerrshme në marrëdhënie dhe pse

18:02 : 18/09/2026



Asnjë masë për uljen e çmimeve, Rama prezanton "Pasqyrën": Qytetarët të zbulojnë ku shitet më lirë

17:59 : 18/09/2026



Macron: Lufta hibride e Rusisë në Europë do të marrë përgjigje!

17:49 : 18/09/2026



Këlliçi ironizon: Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

17:32 : 18/09/2026



E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni

17:14 : 18/09/2026



Detaje/ Abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë, 29-vjeçari pranon se kreu marrëdhënie me vajzën e dajës

17:04 : 18/09/2026



Kryeministri Kurti udhëton në SHBA, zbulohet axhenda e takimeve

16:48 : 18/09/2026

kone duke u përpjekur të bindet se ç'është mjaftueshëm i mirë për të, saqë në fund humbet durimin dhe vendos se nuk ia vlen gjithë kjo përpjekje.

Demi nuk arrin të kuptojë se një partner i mundshëm nuk dëshiron të provojë vazhdimisht se e meriton vëmendjen e tij. Ndonjëherë duhet të marrësh një rrezik dhe t'i lësh gjërat të rrjedhin natyrshëm.

Binjakët

Binjakët kanë vështirësi në marrëdhënie sepse shpesh pendohen pasi kanë bërë zgjedhjen e tyre dhe preferojnë t'i mbajnë mundësitë hapur. Nuk duan të ndihen të lidhur nëse shfaqet dikush që mund t'u duket më i përshtatshëm.

Binjakëve gjithashtu nuk u pëlqen kur gjërat bëhen emocionalisht të ndërlikuara. Për ta, është më e lehtë ta mbajnë dikë në një distancë të sigurt dhe, nëse marrëdhënia nuk shndërrohet në diçka serioze, të paktën ata nuk rrezikojnë të lëndohen.

Gaforrja

Gaforrja është e vështirë në marrëdhënie sepse sheh potencial edhe aty ku ai nuk ekziston gjithmonë. Nëse një partner është i sinqertë që në fillim dhe thotë se nuk dëshiron diçka serioze, Gaforrja mund të mendojë se do t'ia ndryshojë mendjen. Por në këtë mënyrë, nuk po tregohet i/e sinqertë me veten.

Gaforrja nuk mund të zgjedhë dikë vetëm sepse e sheh si një sfidë që duhet ta fitojë. Herën tjetër, duhet ta besojë dikë kur ai thotë se nuk është i interesuar dhe të vazhdojë përpara.

Luani

Luani nuk ka kohë ta harxhojë me marrëdhënie që janë “pothuajse” diçka apo me njerëz që nuk i duken mjaftueshëm të mirë, ndaj zgjedh t'i japë fund lidhjes. Edhe pse kjo është më mirë sesa t'i japësh dikujt shpresa të kota dhe më pas t'ia thyesh zemrën, pikërisht kjo mënyrë veprimi mund ta bëjë Luanin të vështirë në marrëdhënie.

Luani e di çfarë vlere ka dhe nuk dëshiron të kënaqet me më pak nga sa mendon se meriton. Për fat të mirë, vetëbesimi i tij është magnetik dhe njerëzit tërhiqen prej tij, ndaj ka shumë gjasa të mos qëndrojë gjatë vetëm.

Virgjëresha

Virgjëresha prirët të ketë vështirësi në marrëdhënie sepse gradualisht largohet emocionalisht nga partneri. Kur Virgjëresha dhe partneri i saj ndodhen në pika krejt të ndryshme të jetës, ata nuk arrijnë të lidhen në një mënyrë të shëndetshme dhe Virgjëresha vendos të marrë rrugën e saj.

Ajo e di se nuk mund ta detyrojë një marrëdhënie të funksionojë, sidomos kur të dy personave u mungojnë burimet emocionale për të krijuar një lidhje afatgjatë. Megjithatë, kjo nuk e bën më të lehtë humbjen e dikujt që mund ta kishte parë si shpirt binjak.

Peshorja

Peshorja tregohet aq e kujdesshme që të mos thotë apo bëjë diçka të gabuar në një marrëdhënie, saqë përfundon duke mos qenë më vetvetja. Dhe kjo i bën marrëdhëniet e saj joautentike.

Është e pamundur që Peshorja ta mbajë gjatë një marrëdhënie të tillë, sepse ajo ka nevojë për sinqeritet, ndërsa cenueshmëria emocionale e afron më shumë me partnerin. Është bukur që Peshorja mendon për ndjenjat e tjetrit, por jo deri në atë pikë sa të ketë frikë të tregojë veten e saj të vërtetë.

Akrepi

Akrepi ka vështirësi në marrëdhënie sepse gjërat prirën të bëhen shumë intensive që në fillim, por më pas kjo energji shuhet shpejt. Tërheqja nuk mungon, por mungon shumëçka tjetër dhe kjo e bën Akrepin të tërhiqet dhe t'i japë fund marrëdhënies.

Në këtë rast, nuk ka mjaftueshëm baza për të ndërtuar një marrëdhënie të shëndetshme. Gjithçka mund të mbetet vetëm në planin fizik, pa u zhvilluar asgjë më shumë.

Shigjetari

Shigjetari priret të ketë vështirësi në marrëdhënie sepse nuk kalon shumë kohë para se të ndihet sikur lidhja po e mbyl. Ai e vlerëson shumë pavarësinë dhe dëshiron të ndihet i lirë të bëjë atë që dëshiron, pa u ndier i lidhur pas dikujt tjetër.

Sapo përballet me realitetin e marrëdhënies, Shigjetari i jep fund asaj. Ndoshta gjërat mund të ishin rregulluar, por për të, kjo mund të jetë shumë e frikshme.

Bricjapi

Bricjapi është i vështirë në marrëdhënie sepse vendos përgjegjësitë e punës përpara gjithçkaje tjetër, duke lënë shumë pak kohë edhe për të takuar partnerin. Shpesh është thjesht shumë i zënë për një marrëdhënie.

Mund ta bindë veten se mund ta mbajë lidhjen të fortë pavarësisht angazhimeve profesionale, por kjo nuk është gjithmonë e realizueshme. Edhe kur dëshiron një marrëdhënie, Bricjapi mund ta shohë ndarjen si një mundësi për t'iu kushtuar më shumë projekteve të punës.

Ujori

Ujori ka vështirësi në marrëdhënie sepse rrallë kalon kohë vetëm me partnerin. Preferon daljet në grup me miqtë dhe shmang një mbrëmje të qetë vetëm me personin që ka në krah.

Ujori thjesht nuk dëshiron të bëjë gjërat tipike të një çifti bashkë. Madje mund të mos i mbajë as dorën partnerit, duke dhënë përshtypjen se është i ftohtë dhe i painteresuar. Nuk është çudi që partneri mund të largohet nga një marrëdhënie e tillë.

Peshqit

Peshqit kanë vështirësi të mbajnë një marrëdhënie sepse presin që partneri t'u lexojë mendimet. Ata presin që tjetri ta kuptojë se çfarë po ndiejnë në çdo moment, por kjo mund t'i largojë lehtësisht nga partneri.

Nga mënyra se si sillen, partneri mund të mendojë se Peshqit duan vetëm të jenë miq dhe nuk dëshirojnë ta vazhdojnë marrëdhënien romantike. Peshqit duhet të kuptojnë se është e nevojshme të flasin më hapur për nevojat e tyre, në vend që të presin që partneri t'i kuptojë vetë./Anabel

Etiketa: [gaforre](#) [horoskopi](#)

Lajme të lidhura



Horoskopi për ditën e premte, 18 Shtator 2026

23:00 : 17/09/2026



Horoskopi 17 shtator/ Nga dashuria te paratë, si do shkojë dita për secilën shenjë

23:00 : 16/09/2026



Këto 3 shenja do të lënë pas vështirësive

15:01 : 16/09/2026



Horoskopi për ditën e mërkurë, 16 shtator 2026

22:59 : 15/09/2026



Horoskopi për ditën e martë, 15 Shtator 2026

23:00 : 14/09/2026



Fundjavë e vështirë për të gjitha shenjat, kujdes me udhëtimet! Rikthimi i Shironit ditën e premte sjell tensione

14:24 : 14/09/2026

këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun
mediatik.

Na kontakto:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.